




KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
Prishtinë - Prishtina

KOLEGJI "PJETËR BUDI" - PRISTINË



**RR E G U L L O R E
PËR RENDIN SHTËPIAK/
KODI ETIK I STUDENTËVE**

Prishtinë, 2020



Në bazë të nenit 21 të Statutit të Kolegjit “Pjetër Budi” – Prishtinë, Bordi Drejtues i Kolegjit “Pjetër Budi”, me datën 28.12.2020, miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR RENDIN SHTËPIAK/
KODI ETIK I STUDENTËVE**

Neni 1

Me dispozitat e kësaj Rregulloreje përcaktohen të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet e studentëve të regjistruar në Kolegjin “Pjetër Budi” në Prishtinë (në tekstin e mëtejme Kolegji “Pjetër Budi”).

Neni 2

- 2.1. Studentët e regjistruar në Kolegjin “Pjetër Budi” i kanë këto të drejta:
- 2.2. Studenti duhet të trajtohet me respekt dhe mirësi nga mësimdhënësit, kolegët dhe i gjithë stafi i punësuar në Kolegjin “Pjetër Budi”.
- 2.3. Studentin askush nuk guxon ta përqeshë apo ti lëndojë ndjenjat e tij.
- 2.4. Studenti gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve apo provimeve është personalitet në klasë.
- 2.5. Studentin askush nuk guxon ta trajtojë në mënyrë të padrejtë, vetëm për shkak se është vajzë apo djalë, i trashë apo i dobët, i shpejtë apo i ngadalshëm.
- 2.6. Studenti gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, konsultimeve apo provimeve, duhet të jetë i sigurt në klasë, dhe askush nuk guxon ta godas, shtyj, ngacmoj, fyej apo lëndoj në asnjë mënyrë.
- 2.7. Studenti mëson për vet veten dhe në klasë është i lirë të shprehësh ndjenjat dhe mendimet e tij pa frikë se do ta ndërprejnë apo do ta dënojnë për shprehje të mendimit të lirë.
- 2.8. Studenti duhet të çmohet dhe të respektohet i tillë siç është, së bashku me vlerat dhe dobësitë e tij.

Neni 3

- 3.1. Studentët e regjistruar në Kolegjin “Pjetër Budi”, janë të obliguar të kenë sjellje të mira në Kolegj dhe veçmas:
- 3.2. Studenti ka për detyrë që të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me të studentët e tjerë;
- 3.3. Studenti ka për detyrë që t’i respektojë studentët e tjerë;
- 3.4. Studenti nuk do të lejohet që ndaj mësimdhënësit, kolegëve apo stafit të punësuar në Kolegj të përdor dhunë dhe agresiviteti fizik, duke përfshirë edhe lojërat “luftarake”.

Neni 4

- 4.1. Studenti çdo herë është përgjegjës për veprimet apo sjelljet jo të mira tij si dhe për mos veprimet.
- 4.2. Në rastin e sjelljeve jo të mira, atëherë Rektori i Kolegjit “Pjetër Budi”, është i obliguar që paraprakisht të ftojë studentin në bisedë, i cili varësisht nga pesha e gabimit të bërë, mund ta detyroj studentin të kryej ndonjë shërbim ose të filloj procedurën për shqiptimin a ndonjë nga masat disiplinore.

Neni 5



5.1. Kolegji “Pjetër Budi” do t’i përkrah studentët me sjellje të mira, me vetë-disiplinë dhe studentët me vullnet për mësim.

5.2. Në momentet kur studenti sillet mirë dhe tregon rezultate në mësim, kjo do të vlerësohet nga ligjëruesi.

5.3. Nëse studenti tregon rezultate të mira në mësim apo aktivitete tjera, ai/ajo do të shpërblehet nga ligjëruesi.

Neni 6

6.1. Nëse studenti ndihet i ofenduar për shkak të sjelljeve të tjerëve ndaj tij, atëherë ai ka të drejtë që të kërkojë që kjo sjellje e pahijshme ndaj ti të ndërpritet.

6.2. Kërkesën lidhur me këtë duhet drejtuar ligjëruesit apo Rektorit të Kolegjit.

Neni 7

7.1. Studenti në Kolegji lejohet të sjellë vetëm gjëra të nevojshme për procesin arsimor.

7.2. Studenti është përgjegjës për çdo gjë që e sjell në Kolegji.

7.3. Në rastet kur studenti në Kolegji bart me veti telefon mobil, llap top apo ndonjë gjë me vlerë, atëherë ai duhet të kujdeset mirë për të.

7.4. Telefoni mobil gjatë orëve të ligjëratave, konsultimeve, ushtrimeve apo provimeve, duhet të mbahet i fikur.

7.5. Rreptësisht ndalohet të sillen në Kolegji, mjete të forta apo çfarëdo tjetër që do të mund të lëndojë dikë në ambientet e Kolegjit.

Neni 8

8.1. Studenti gjatë qëndrimit në ambientet e Kolegjit “Pjetër Budi” është i obliguar që të respektoj të tjerët dhe vetveten dhe veçmas është i obliguar:

8.1.1. të dëgjoj gjatë orës së ligjëratave dhe bashkëpunoj me të tjerët;

8.1.2. të vijoj me rregull ligjëratat dhe t’i kryej të gjitha obligimet me kohë;

8.1.3. nuk guxon t’ia lejoj vetes që të tjerët të ia tërheqin vëmendjen më shumë se ligjëratat;

Neni 9

9.1. Studenti është i obliguar që të respektoj stafin akademik dhe nuk guxon të jetë i dhunshëm apo agresiv në ambientet e Kolegjit “Pjetër Budi”.

9.2. Studenti duhet të jetë tolerant, i shoqërueshëm dhe nuk guxon ti përqesh apo ti ofendoj kolegët apo edhe personat e tjerë në Kolegji.

9.3. Studenti është i obliguar të përkujdeset për orenditë dhe pajisjet e punës së Kolegjit, duke mos i dëmtuar dhe duke mos marr asgjë nga ambientet dhe sallat e mësimi.

Neni 10

10.1. Përgjegjësitë e studentëve gjatë orëve të ligjëratave janë:

10.1.1. Studenti është i obliguar të respektojë rendin në klasë dhe të dëgjojë me vëmendje kur ligjëruesi flet;

10.1.2. Të mos pengojë shokun ose shoqen gjatë orës së ligjëratave, konsultimeve, ushtrimeve apo provimeve, ose gjatë aktiviteteve të lira, duke i ndërhyrë verbalisht ose duke e ngacmuar fizikisht;

10.1.3. Të mos ndërrojë grupin kur atij ose asaj i teket, pa kurrfarë shkasi dhe pa lejen e ligjëruesit;

10.1.4. Të mos e dëmtojë inventarin në klasë dhe ta mirëmbajë atë;

10.1.5. Të mos i dëmtojë muret e klasës, duke i varur punimet e ndryshme,



Neni 11

Procedurën disiplinore ndaj studentit e inicion Udheheqesi i Programit të Studimit ose ligjëruesi, i cili ia përcjell propozimet e veta Rektorit të Kolegjit.

Neni 12

12.1. Me fillimin e procedurës disiplinore do të mbahet një bisedë në mes të Rektorit dhe studentit, ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore. Në këtë bisedë mund të jenë të pranishëm edhe anëtarë tjerë të stafit akademik të ftuar nga rektori.

12.2. Pas përfundimit të bisedës dhe shqyrtimit të gjithanshëm të fakteve, rektori merr vendim për lirim të studentit nga përgjegjësia ose për shqiptimin e masës disiplinore të përcaktuar me këtë Rregullore.

12.3. Rektori mund ta largojë përkohësisht studentin nga Kolegji deri në përfundim të procedurës disiplinore.

Neni 13

13.1. Masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen, për shkak të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje janë:

13.1.1. Kompensim i dëmit material

13.1.2. Vërejtje

13.1.3. Vërejtje me shkrim

13.1.4. Largimi i përkohshëm nga Kolegji (deri në 5 ligjërata)

13.1.5. Përfundim nga Kolegji.

13.2. Masa e fundit e përfundimit nga Kolegji, do të aplikohet vetëm nëse janë shterë të gjitha mundësitë tjera për zgjidhjen e problemit.

13.3. Masa e përfundimit nga Kolegji hyn në fuqi me vërtetimin e saj nga ana e Bordit Drejtues të Kolegjit.

Neni 14

Me këto rregullore shfaqet rregullorja e vjetër për rendin shtëpiak/Kodi Etik të Studenteve.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi i Kolegjit "Pjetër Budi" - Prishtinë.

Presidenti i Bordit Drejtues
Besim AJETI